

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË –Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykses Gjyqtari Shaqir Zika, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. M. B. nga fshati B. K- Malishevë, për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 prg 1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.79/2018 të dt.07.12.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit për shqyrtimit e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur më dt. 26.12.2018, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurorit të shtetit Agron Matjani, të akuzuarit F. B. dhe mbrojtësit të tij av. B. K. nga Malisheva, sipas autorizimit, të njëjtën ditë muar dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F. B. nga fshati B. K- Malisheve, nga i ati M. dhe ëma N., e gjinisë K., data e lindjes ..., në fshatin Banje K- Malisheve, i martuar, i ati i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin në Ndërtimtarisë menaxher i biznesit B. G., i gjendjes së mesme ekonomike me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 18.11.2018 në ora 16:00, në Malishevë, si pronar i biznesit “ B. G” nga fshati B. të Komunës së Malishevës, në mënyrë të drejte për drejte jep dhuratë personit zyrtar Inspektorit të Punës në Prizren, Rr. M., në mënyrë që ai të mos veprojë me pajtim me detyrën e tij zyrtare në atë mënyrë që në firmën “ B. G.” për një rast të evidentuar me numër ..., që kishte ndodhur me lëndimin e një punëtorit A. Y. data e lindjes ... në Ankara nga Shtetit i Turqisë, dhe pas dorëzimit të raportit zyrtarë një kopje e raportit është dorëzuar pronarit të kompanisë i cili në një zarf ka futur raportin dhe brenda zarfit kishte futur edhe 500€, të njëjtën zarf Inspektori e kishte dërguar në Stacionin Policore në Malishevë.

-me çka ka kryer veprën penale, dhënia e ryshfetit nga neni 429 prg 1 të KPRK-se,

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 75, 76, nenit 429 par. 1 të KPRK-se dhe nenit 233 prg 21, 247 dhe 365 të KPPK-se, të pandehurit i shqipton

DENIMI ME BURGIM I CILI ME PELQIMIN E TË PANDEHURIT ËSHTË ZEVENDESUAR ME DËNIM ME GJOBË

Ashtu qe të pandehurit F. B. i shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 3.000 (tre mije) €, e i cili dënim i pandehuri do te paguaj ne afat prej 15 ditëve, nga dita kur ky aktgjykim te behet i formës se prere.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund te paguaj gjobën i kthehet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve.

I shqiptohet dënimi plotësues i konfiskohet parat ne vlere prej 500€, dhe atë 1 here 200 €, me numër serik ..., 1 here 200 € ..., dhe një here 100 € ..., si objekt i veprës penale, komform nenit 69 t e KPRK-se, dhe te njëjta te holla do ti dorëzohet ne Agjensionin për administrimin e pasurisë se sekuestruar ose te konfiskuar si organ kompetent për administrimin e pasurisë së konfiskuar e cila është fituar si rezultat i veprës penale.

I akuzuari F. B. , obligohet që ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa të jenë sipas llogarisë së kësaj Gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50(pesëdhjetë) €, ne emër taksës për kompensimit te viktimave te krimit te paguaj shume prej 50€, te gjitha këto ne afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I. nr. 79/2018, te dt. 07.12.2018, kundër te akuzuarit F. M. B. nga fshatin B. K- Malisheve, për shkak te veprës penale, dhënia e ryshfetit nga neni 429 para 1 te KPRK-se, me propozim për caktimin e seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjykata ka caktuar seancën shqyrtimit te marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani, i akuzuari F. B. si dhe mbrojtësit i tij av. B. K. nga Malisheva.

Gjykata gjate seancës dëgjimore të shqyrtimit te marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka dëgjuar te akuzuarin, mbrojtësin e tij, si dhe përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, - Departamenti për krime te Renda, Prokurori i Shtetit Agron Matjani .

Prokurori i shtetit ka deklaruar se ne tërësi ngel pranë marrëveshjes me nr. PP/I.nr. 79/2018, te dt. 07.12.2018, e lidhur ne mes te Prokurorit, te akuzuarit dhe mbrojtësit te tij, e cila marrëveshje është arritur me dt. 07.12.2018, dhe e njëjta marrëveshje është lidhur pasi qe unë si Prokurori i Çeshtjes kam marrë pëlqimin nga ana e Kryeprokurorit mbrojtësit te akuzuarit i ka shpjeguar te akuzuarit për te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe me te njëjtin kemi arritur marrëveshje dhe i kemi nënshkruar te gjitha palët ne procedurë, dhe se aktakuza mbështet ne provat materiale te propozuara ne aktakuze e te siguruara gjate procedurës se hetimeve andaj i ka propozuar Kryetarit te Trupit Gjykes qe marrëveshjen e arritur te aprovoi.

Mbrojtësit i te akuzuarit F. B. av, B. K., ka deklaruar se: pas konsultimeve te nevojshëm me te mbrojtur tim i ka shpjeguar për te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë me Prokurorinë e Shtetit kemi hyre ne negociata për pranimin e fajësisë me vullnete te plote te mbrojturit tim pa ndonjë shtrëngim apo presion e çfarë do lloji, kemi pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë lidhur me veprën penale i cili është ngarkuar ne aktakuzë dhe konsideroi se marrëveshja e arritur është komform dispozitave ligjore te Kodit procedurës penale, i mbrojturi im ka kuptuar për te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë , andaj i ka propozuar Kryetarit te Trupit Gjykes qe te njëjtën marrëveshje te aprovoi.

I akuzuari F. B. ka deklaruar se: ne tërësi ngelë pranë marrëveshjes e arritur ne mes te Prokurorit te Shtetit mbrojtësit te tij, dhe te pandehurit, mbrojtësi im me ka shpjeguar për te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe këtë marrëveshje e kemi arritur me vullnet te plote timin, pa ndonjë kërcënim apo shtrëngim dhe i propozoi Gjykatës qe te njëjtin te aprovoi.

Gjykata pas dëgjimit te pretendimeve te Prokurorit te akuzuarit mbrojtësit te tij, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka konstatuar se i akuzuari F. B. , ka kuptuar natyrën dhe pasojat te pranimit te fajësisë, ky pranim është bërë ne baza vullnetare pas konsultimeve te nevojshëm me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qene i detyruar ose i shtrënguar ne asnjë mënyrë që te pranoi fajësinë, pranimi i fajësisë mbështet ne fakte dhe prova te cilat janë paraqitur ne aktakuzë, dhe janë pranuar dhe nga vete i akuzuari. Po ashtu Gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës, apo te pushimit te procedurës penale te parapara me nenin 248 para 3 te KPPK-se.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e te akuzuarit por edhe nga provat qe gjenden ne shkresat e lëndës, dhe a të nga raporti fillestar i incidentit me numër te rastit 2018- KE- 310, te dt. 19.11.2018, nga raporti i oficerit policore Sh. M., me numër te njëjtë i rastit i dt. 18.11.2018, raporti i oficerit Kujtim Krasniqi, me numër te njëjtë te rastit i dt. 18.11.2018, vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve nga lista e dëshmimeve dhe zingjiri i ruajtjes i dt. 18.11.2018, nga raporti i zyrtarit te inspektimit lidhur me lëndimin e te punësuarit ne punë te Inspektoriati te punës me numër 322 /2018 te dt. 06.11.2018, si dhe shiqimit ne te holla te konfiskuar ne shume prej 500€ ai objekt i kryerjes se veprës penale.

Andaj, Gjykata ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elemente qenësore të përshkruar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, dhe përket ka vendosur qe te pranoi fajësinë e të akuzuarit dhe te akuzuarin te shpalli fajtores dhe te dënoi ne baze te Ligjit.

Gjate seancës për caktimin e dënimit Prokurori i Çeshtjes ka deklaruar se: mbetet pranë dënimit te rekomanduar ne marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ku është propozuar që te akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj, e i cili dënim me pëlqimin e te akuzuarit do te zevendesohet me dënim me gjobe ne shume prej 2.700€ deri ne 3.000€, ne kuptim te nënti 47 te KPRK-se, si dhe ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohet shume prej 500€, si objekt i kryerjes se vepres penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. B., av. B. K. nga Malisheva , ka deklaruar se e përkrah dënimin e përcaktuar ne marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, për te cilin ngarkohet i mbrojturi im dhe se për kete vepër penale është parapare dënimi me gjobe apo burgim deri ne 3 vite dhe dënimi i propozuar është ne kuadër t e dënimit te parapare me Ligj, andaj i propozoi Gjykatës qe ti shqiptohet dënimi minimal ne kuadër te marrëveshjes, i mbrojturi im është hera e pare qe ndeshet me Ligjin, është mbajtës i vetëm i familjes i martuar i ati i dy fëmijëve, andaj edhe me dënimin minimal do te arrihet qëllimi i dënimi i parapare me Ligj.

I akuzuari F. B. ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, dhe pendohet për veprën e kryer dhe shpreh keq ardhje, dhe ka premtuar që në të ardhmë nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penal juridike të propozuar në marrëveshje ka vlerësuar të gjitha rrethanat komform nenit 73, 75 para 1, pika 1.3, dhe nënti 76 të KPRK-se, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti se pranimin e fajësisë nga ana e tij, në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tij, për veprën e kryer qëndrimin e tij korrekte gjatë gjykimit, jo dënueshme rinë e tij, është në moshe të re, është mbajtës i vetëm i familjes i ati i dy fëmijëve, andaj të njëjti i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e në kuptim të nënti 47 të KPRK-se, kur Gjykata shqipton dënimin me burgim deri në 6 muaj, Gjykata njëkohësisht mund të vendos se dënimin me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobe me pëlqimin e personit të dënuar. Andaj dënimin i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësin penal të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par 3 të KPPK-se, ndërsa lidhur me taksën për kompensimit të krimit është vendosur në bazë të nenit 39 prg 3 nën prg 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga aresyrat e cekura më lartë dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 të KPPK-se është vendosur në dispozitave të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, - Departamenti për krime të Renda,
PKR.nr. 60/15, te dt. 26.12.2018**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.

